



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 01/68

Datë: 08.03.2021

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 06/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 07/2020, në pajtim me nenin 17 dhe 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria në detyrë e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 8 mars 2021, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohen procesverbalet nga mbledhjet korresponduese\elektronike: 66 dhe 67 të Qeverisë së Republikës së Kosovës.
2. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Avdullah HOTI

Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 02/68

Datë: 08.03.2021

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 6 të Ligjit Nr.04/L-145 për Organet Qeveritare për Shoqërinë e Informacionit, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr.06/2020 për Fushat e Përgjegjësive Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr.07/2020, në pajtim me nenin 17 dhe 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria në detyrë e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 8 mars 2021, merr këtë:

V E N D I M

1. Të gjitha institucionet publike në Republikën e Kosovës obligohen që të bashkërendojnë aktivitetet e tyre me Agjencinë e Shoqërisë së Informacionit në Ministrinë e Punëve të Brendshme (ASHI/MPB), për zhvillimin e sistemeve elektronike dhe integrimin e tyre në infrastrukturën dhe platformat qendrore të sistemeve të informacionit në pajtim me legjislacionin në fuqi.
2. Obligohet ASHI/MPB të paraqesë për miratim në Qeveri draftin e Strategjisë së Qeverisjes Elektronike brenda tre (3) muajve.
3. Obligohet Policia e Kosovës që të rrisë kapacitetet hetuese për parandalimin e sulmeve kibernetike në bashkëpunim me institucionet relevante vendore dhe ndërkombëtare.
4. Vendimi hyn në fuqi në ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Avdullah HODI

Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 03/68

Datë: 08.03.2021

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 3, 4, 8, 44 dhe 45 të Ligjit nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 06/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 07/2020, në pajtim me nenin 17 dhe 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria në detyrë e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 8 mars 2021, merr këtë:

V E N D I M

1. Miratohet shqyrtimi i mëtejshëm i kërkesës për shpronësim për interes publik të pronave të paluajtshme ish shoqërore të cilat janë të nevojshme për realizimin e projekteve të Këshillit Gjyqësor të Kosovës (KGJK) për:
 - Ndërtimi i Objektivit të ri të Gjykatës Themelore në Pejë, në parcelat ish prona shoqërore nr. 311-0 dhe 312-0 ZK Pejë, Komuna Pejë;
 - Ndërtimi i Objektivit të ri të Gjykatës Themelore në Prizren, në parcelën ish pronë shoqërore nr. 9013-2 ZK Prizren, Komuna Prizren;
 - Renovimi dhe ndërtimi i ish Objektivit të "Jugobanka" Filiala Mitrovicë, për nevoja të Gjykatës Themelore në Mitrovicë, parcelat (tokat dhe objekti) ish prona shoqërore nr. 608-1 dhe 610-1 ZK Mitrovicë, Komuna Mitrovicë, sipas tabelave bashkëngjitur këtij vendimi.
2. Vlera e kompensimit të objekteve të vjetëruara do të caktohet nga Ministria e Financave, konform Ligjit nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205 dhe Udhëzimit Administrativ nr.02/2015 "Për zbatimin e metodave dhe kriterëve teknike të vlerësimit që do të përdoren për përlllogaritjen e shumës së kompensimit për pronën e paluajtshme që shpronësohet dhe dëmeve që kanë të bëjnë me shpronësimin".
3. Brenda dhjetë (10) ditëve të punës pas miratimit të këtij vendimi, Departamenti i Shpronësimit, konform nenit 8 paragrafi 8 të Ligjit nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205, bënë shpalljen e vendimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe në një gazetë ditore me tirazh të madh në Kosovë.
4. Kompensimi i pronave të shpronësuar dhe të gjitha obligimet tjera financiare dhe ligjore që mund të rrjedhin nga procesi i shpronësimit do të bëhet nga buxheti i Këshillit Gjyqësor të Kosovës(KGJK).
5. Për zbatimin e këtij Vendimi obligohen Departamenti i Shpronësimit, Këshilli Gjyqësor i Kosovës (KGJK), Ministria e Financave dhe Ministria e Drejtësisë.

6. Vendimi hyn në fuqi në datën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe në një gazetë me tirazh të madh në Kosovë.

Avdullah HOTI



Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 04/68

Datë: 08.03.2021


Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 3, 4, 8 dhe 45 të Ligjit nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 06/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr.07/2020, në pajtim me nenin 17 dhe 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria në detyrë e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 8 mars 2021, merr këtë:

V E N D I M

1. Miratohet shqyrtimi i mëtejme i kërkesës për shpronësim të pronave të paluajtshme:
 - "Objektit të Banimit-Shtëpisë", parcelat nr. 2865-0 dhe 2866-0, Zona Kadastrale Bresallc, Komuna e Gjilanit, e cila preket nga ndërtimi i Autostradës Prishtinë-Gjilan-Dheu i Bardhë;
 - "Objektit të Banimit-Shtëpisë", parcela nr. 505-1, Zona Kadastrale Balincë, Komuna e Malishevës, e cila preket nga ndërtimi i Rugës Nacionale N9, Prishtinë-Pejë; dhe
 - "Objektit të Banimit-Shtëpisë" parcela nr. 653-0, Zona Kadastrale Milloshevi, Komuna e Obilqit, e cila preket nga ndërtimi i Rugës Nacionale N2 Prishtinë-Mitrovicë, sipas tabelave të bashkangjitura këtij vendimi.
2. Vlera e kompensimit të pronave do të caktohet nga Ministria e Financave, konform Ligjit Nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205, dhe Udhëzimit Administrativ Nr. 02/2015 "Për zbatimin e metodave dhe kriterëve teknike të vlerësimit për përlllogaritjen e shumës së kompensimit për pronën e Paluajtshme që shpronësohet, dhe dëmeve që kanë të bëjnë me shpronësimin.
3. Brenda dhjetë (10) ditëve të punës pas miratimit të këtij vendimi, Departamenti i Shpronësimit bënë shpalljen e vendimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe në një gazetë ditore me tirazh të madh në Kosovë.
4. Për zbatimin e këtij Vendimi obligohen Departamenti i Shpronësimit, Ministria e Infrastrukturës dhe Ministria e Financave.

5. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe në një gazetë me tirazh të madh në Kosovë.

Avdullah HOTI



Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 05/68

Datë: 08.03.2021

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 11, 39, 44 dhe nenit 45 të Ligjit nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205, të nenit 53 të Ligjit Nr. 05/L-031 Për Procedurën e Përgjithshme Administrative, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr.06/2020 për Fushat e Përgjegjesisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr.07/2020, në pajtim me nenin 17 dhe 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria në detyrë e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 8 mars 2021, merr këtë:


V E N D I M

Për anulimin, ndryshimin dhe plotësimin e pjesërishëm të Vendimit Përfundimtar Nr.12/71 datë 23.10.2018

1. Anulohen shpronësimet e miratuara me Vendimin Përfundimtar Nr.12/71 të datës 23.10.2018 me të cilin janë miratuar shpronësimet e pronave të cilat preken nga ndertimi i Autostradës "Prishtinë-Gjilan-Dheu i Bardhë" Segmenti Banullë-Bresallc, që prek Komunitat Lipjan (Zonat Kadastrale Banullë, Sllovi, Smallushë), Novobërdë (zona kadastrale Parallovë) dhe Gjilan (zonat kadastrale Bresalc, Ponesh dhe Zhegovc), sipas tabelave bashkëngjitur këtij vendimi, Aneksi I.
2. Miratohet shpronësimi për interes publik i pronave të paluajtshme të pronarëve dhe zotëruesve të interesit të cilat preken nga ndertimi i Autostradës "Prishtinë-Gjilan-Dheu i Bardhë" Segmenti Banullë-Bresallc, që prek Komunitat Lipjan (zonat kadastrale Banullë, Sllovi, Smallushë), Novobërdë (zona kadastrale Parallovë) dhe Gjilan (zonat kadastrale Bresalc, Ponesh dhe Zhegovc), sipas korigjimit të vijës së shpronësimit nga Ministria e Infrastrukturës dhe Aktvendimit Nr.10-942-51703-2019 nga Drejtoria e Kadastrit Gjilan, sipas tabelave bashkëngjitur këtij vendimi, Aneksi II.
3. Obligohet, Zyra për Vlerësimin e Pronave të Paluajtshme/Ministria e Financave që brenda afatit 5 ditor pas miratimit të këtij Vendimi dhe pranimit të tij nga Departamenti i Shpronësimit të punojë Aktet e Vlerësimit të Pronës sipas tabelave bashkëngjitur këtij vendimi, Aneksi II.
4. Brenda dhjetë (10) ditëve të punës pas miratimit të këtij vendimi, Departamenti i Shpronësimit bënë shpalljen e vendimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe në një gazetë ditore me tirazh të madh në Kosovë.
5. Obligohet, Departamenti i Shpronësimit, t'ju dërgojë vendimin subjektit kërkues dhe personave të tjerë të identifikuar në tabelat e përcaktuara në pikën 1 dhe 2 të këtij vendimi.

6. Pjesë integrale e këtij vendimi është akti i vlerësimit dhe tabelat të bashkëngjitura këtij vendimi në të cilat është përcaktuar shuma e kompensimit për ata pronarë apo zotërues interesi, të drejtat pronësore ose interesat e ligjshme të cileve i'u janë prekur nga procesi i shpronësimit.
7. Kundër këtij vendimi subjektet kanë të drejtë të paraqesin ankesë brenda tridhjetë (30) ditëve kalendarike në gjykatën kompetente, vetëm për kundërshtimin e shumës së kompensimit të përcaktuar në këtë vendim, subjekti kërkues, cilido person i cili është pronar ose zotërues i interesit, ne pronën e palujtshme ose të drejtat pronësore të prekura nga ky vendim, si dhe çdo person i interesuar i cili ka një interes legjitim të drejtpërdrejtë dhe material në pronën e palujtshme e cila është objekt i vendimit përfundimtar, pavarësisht nëse është identifikuar apo jo në tabelat e bashkëngjitura të këtij vendimi.
8. Brenda pesë (5) ditëve kalendarike pas dorëzimit të ankesës në gjykatën kompetente parashtruesi i ankesës duhet të sigurojë që pesë (5) kopje të ankesës të dorëzohen fizikisht në zyrën ligjore të Organit përkatës Shpronësues, nëse parashtruesi i ankesës nuk vepron në përputhje me këtë paragraf, gjykata e refuzon ankesën.
9. Brenda dy (2) viteve nga data e hyrjes në fuqi të vendimit dhe pas aplikimit të pronarëve me dokumentacionin valid personal dhe pronësoro-juridik, Departamenti i Shpronësimit do të paguajë shumën e kompensimit të shpronësimit, të përcaktuar në këtë vendim.
10. Vendimi hyn në fuqi në datën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe në një gazetë me tirazh të madh në Kosovë.

Avdullah HOTI



Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 06/68

Datë: 08.03.2021


Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 11 dhe 45 të Ligjit nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 06/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 07/2020, në pajtim me nenin 17 dhe 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria në detyrë e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 8 mars 2021, merr këtë:

V E N D I M P Ë R F U N D I M T A R

1. Miratohet shpronësimi për interes publik i Objekteve të cilat menaxhohen nga Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP), e të cilat preken nga realizimi i projekteve: ndërtimi i Parkut që do të shërbeje për amfiteatrin e fshatit Mushtisht dhe ndërtimi i "Çerdhes së fëmijëve dhe këndi për të moshuarit" në fshatin Studentçan, Komuna e Suharekës, sipas tabelave bashkëngjitur këtij vendimi.
2. Pjesë integrale e këtij vendimi është akti i vlerësimit i punuar nga Zyra për Vlerësimin e Pronës së Paluajtshme/Ministria e Financave dhe tabela e bashkëngjitur këtij vendimi në të cilën është përcaktuar shuma e kompensimit për ata pronarë apo zotërues interesat, të drejtat pronësore ose interesat e ligjshme të cileve i'u janë prekur nga procesi i shpronësimit.
3. Brenda 5 (pesë) ditëve të punës pas nxjerrjes së këtij vendimi, Departamenti i Shpronësimit, i dërgonë vendimin subjektit kërkues dhe personave të tjerë të identifikuar në tabelat e përcaktuara në pikën 1 të këtij vendimi.
4. Brenda dhjetë (10) ditëve të punës pas miratimit të këtij vendimi, Departamenti i Shpronësimit bënë shpalljen e vendimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe në një gazetë ditore me tirazh të madh në Kosovë.
5. Kundër këtij vendimi subjekti kërkues, cilido person i cili është pronar ose zotërues i interesit në pronën e paluajtshme ose të drejtat pronësore të prekura nga ky vendim, si dhe çdo person i interesuar i cili ka një interes legjitim të drejtpërdrejtë dhe material në pronën e paluajtshme e cila është objekt i vendimit përfundimtar, pavarësisht nëse është identifikuar apo jo në tabelat e bashkëngjitura të këtij vendimi, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditëve kalendarike kanë të drejtë për të ushtruar ankesë pranë gjykatës kompetente vetëm sa i përket lartësisë së shumës së kompensimit të përcaktuar me këtë vendim.
6. Brenda pesë (5) ditëve kalendarike pas dorëzimit të ankesës në gjykatën kompetente parashtruesi i ankesës duhet të sigurojë që pesë (5) kopje të ankesës të dorëzohen fizikisht në Zyrat e Avokaturës Shtetërore/Ministria e Drejtësisë dhe një (1) kopje të ankesës në Zyrat e Departamentit të Shpronësimit.

7. Brenda dy (2) viteve nga data e hyrjes në fuqi të vendimit dhe aplikimit të pronarit për pagesë të pronës, Komuna e Suharekës do të paguajë shumën e kompensimit të shpronësimit, të caktuar në aktin e vlerësimit i cili është pjesë e këtij vendimi, konform Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit.
8. Ky vendim bashkë me pjesët tabelare dhe grafike të tij paraqet bazë juridike për regjistrim në librat kadastral në emër të titullarëve të rinj si dhe ndarjeve teknike të parcelave kadastrale. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, zyra kadastrale është e obliguar të kryej veprimet procedurale dhe teknike për zbatimin e tij.
9. Vendimi hyn në fuqi në datën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe në një gazetë me tirazh të madh në Kosovë.

Avdullah HOTI



Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 07/68

Datë: 08.03.2021

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 11 të Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, nenit 6 të Ligjit Nr. 04/L-111 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr.06/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr.07/2020, në pajtim me nenin 17 dhe 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria në detyrë e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 8 mars 2021, merr këtë:

V E N D I M

1. Themelohet Ndermarrja Publike Lokale " Kastrioti SH.A." Obiliq.
2. Ndermarrja Publike Lokale NPL " Kastrioti SH.A." Obiliq themelohet me 100% aksione nga KK Obiliq.
3. Komuna e Obiliqit autorizohet që të veproj në emër të aksionarit të NPL " Kastrioti SH.A." dhe të ndermarr të gjitha veprimet e ligjshme duke përfshirë edhe regjistrimin sipas Ligjit Nr. 02/L-016 për Shoqëritë Tregtare (G.Z. nr. 09/24 maj 2018).
4. Komuna e Obiliqit të drejtat e saj të aksionarit do t'i ushtroj nga Komisioni Komunal i Aksionarëve, në emër të komunës përkatëse bazuar në legjislacionin në fuqi.
5. Obligohet Komuna e Obiliqit për zbatimin e këtij Vendimi.
6. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Avdullah HOTI

Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 08/68

Datë: 08.03.2021

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4 dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Ligji Nr. 03/L-175 për Borxhet Publike, Ligji Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, Ligji Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin Nr. 03/L-221, Ligjin Nr. 04/L-116, me Ligjin Nr. 04/L-194, me Ligjin Nr. 05/L-063 dhe me Ligjin Nr. 05/L-007, Rregullores QRK - Nr. 22/2013 mbi Procedurat për Emetimin dhe Menaxhimin e Borxheve Shtetërore, Garancive Shtetërore dhe Borxheve Komunale, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr.06/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr.07/2020, nenin 17 dhe 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr.09/2011, Qeveria në detyrë e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 8 mars 2021, merr këtë:

V E N D I M

1. Obligohet Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit (MEA) që në bashkëpunim me Ndërmarrjet Publike Qendrore të përgatis dhe raportojë në Thesarin e Kosovës (MF), të dhënat e plota, me kohë dhe të sakta, për huamarrjet e brendshme dhe ndërkombëtare të Ndërmarrjeve Publike Qendrore.
2. Raportimi nga pika 1. e këtij vendimi nga MEA tek Thesari i Kosovës (MF) duhet bëhet në baza tremujore, jo më larg se 15 ditë pas përfundimit të çdo tremujori.
3. Obligohet Thesari i Kosovës (Divizioni për Menaxhimin e Borxhit Publik), që të dhënat e pranuar nga MEA për borxhin e Ndërmarrjeve Publike Qendrore t'i raportojë në kuadër të statistikave të borxhit të përgjithshëm, dhe publikojë në raportin tremujor në faqen zyrtare të Ministrisë së Financave, më së largu deri më 30 mars 2021.
4. Thesari i Kosovës (Divizioni për Menaxhimin e Borxhit Publik) ofron udhëzime për MEA-në dhe Ndërmarrjet Publike Qendrore mbi kërkesat për raportim.
5. Obligohet Ministria e Financave dhe Thesari me rastin e rishikimit të legjislacionit, të përfshij kërkesën për raportim nga pika 1. e këtij vendimi, në kuadër të legjislacionit përkatës për borxhin publik.
6. Obligohet Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit, Ministria e Financave, Thesari i Kosovës dhe Ndërmarrjet Publike Qendrore për zbatimin e këtij vendimi.
7. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Arsyetim

Për rritjen e transparencës lidhur me menaxhimin e borxhit në mënyrë efektive dhe efikase, Ndërmarrjet Publike Qendrore janë të obliguara të veprojnë në përputhje me këtë vendim dhe legjislacionin përkatës në lidhje me menaxhimin e borxhit publik, në përputhje me Politikën e re të Bankës Botërore për Financimin e Zhvillimit të Qëndrueshëm (IDA 19 Sustainable Development Financing Policy), të cilën Republika e Kosovës është dakorduar ta vë në zbatim, sipas shkresës të Ministrit të Financave nr. 998, datë 27.07.2020.

Avdullah HOTI



Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Ndërmarrjeve Publike Qendrore
- Arkivit të Qeverisë